PËRMBLEDHJA E KONTRATËS PËR SHËRBIMET MOBILE NË RRJETIN E TELEKOMIT TË KOSOVËS SH.A.

Ofruesi i Shërbimeve të komunikimeve elektronike:

| | |
|---|---|
| *Emri:* | *Telekomi i Kosovës Sh.A.* |
| *NUI:* | *811288001* |
| *Adresa:* | *Lagjja Dardania p.n., Prishtinë* |
| *Kontakti:* | *Tel: 0800 10000* |
| | Email: info@kosovotelecom.com, |
| | Faqja zyrtare: www.kosovotelecom.com |
| | Rrjeti social: https://www.facebook.com/valamobile/ |

Kjo përmbledhje e kontratës, prezanton karakteristikat e shërbimeve dhe produkteve që Telekomi i Kosovës i ofron nëpërmjet rrjetit mobil të telekomunikacionit dhe synon të ndihmojë konsumatorin për të përzgjedhur shërbimin/produktin e përshtatshëm për të.

Informacionin e plotë për termat dhe kushtet e përgjithshme të shërbimeve mobile mund ta gjeni në faqen zyrtare të Telekomit të Kosovës: www.kosovotelecom.com, si dhe në pikat shitëse të saj.

## 1. Shërbimet dhe pajisjet

1.1. Telekomi i Kosovës ofron pako të ndryshme me faturim mujor të shërbimeve mobile.

1.2. Pakot e shërbimeve mobile me çmimet përkatëse, të cilat i ofrohen konsumatorit janë si në vijim:

| | Postpaid Individual | | IN | PRIME | PLUS | ELITE | SUPER | PREMIUM |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Përmbajtja | Çmimi pa zbritje/muaj | | 14.95 €uro | 19.95 €uro | 24.95 €uro | 34.95 €uro | 49.95 €uro | 64.95 €uro |
| | Zbritja/muaj | | 3.13 €uro | 5.00 €uro | 5.21 €uro | 8.75 €uro | 12.50 €uro | 21.67 €uro |
| | Çmimi me zbritje/muaj | | 11.82 €uro | 14.95 €uro | 19.74 €uro | 26.20 €uro | 37.45 €uro | 43.28 €uro |
| | Minuta në Vala mobil dhe Vala fiks | | 2.000 | 3.000 | 4.000 | 6,000 | 10,000 | 15,000 |
| | Minuta nacional dhe Ballkan Perëndimor | | 1,000 | 1,500 | 2,000 | 3,000 | 4,000 | 5,000 |
| | SMS Vala, nacional dhe Ballkan Perëndimor | | 500 | 600 | 800 | 1,000 | 1,500 | 2,000 |
| | **Internet për Kosovë** | | **40 GB** | **60 GB** | **100 GB** | **150 GB** | **200 GB** | **300 GB** |
| | Internet për Roaming në kuadër të internetit për Kosovë | Ballkan Perëndimor | 5 GB | 7 GB | 8 GB | 11 GB | 15 GB | 16 GB |
| | | Regjion | 2 GB | 3 GB | 3 GB | 4 GB | 5 GB | 8 GB |
| | | Evropë | 1 GB | 1 GB | 2 GB | 3 GB | 5 GB | 5 GB |

| | Klubet Familjare | | Fam1 | Fam2 | PRIME | Fam3 | Fam4 | Fam5 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Përmbajtja | Çmimi pa zbritje/muaj | | 10.00 €uro | 15.00 €uro | 19.95 €uro | 25.00 €uro | 35.00 €uro | 50.00 €uro |
| | Zbritja/muaj | | 2.08 €uro | 3.13 €uro | 5.00 €uro | 5.21 €uro | 8.75 €uro | 12.50 €uro |
| | Çmimi me zbritje/muaj | | 7.92 €uro | 11.87 €uro | 14.95 €uro | 19.79 €uro | 26.25 €uro | 37.50 €uro |
| | Minuta në Vala mobil dhe Vala fiks | | 1,000 | 2,000 | 3,000 | 4,000 | 6,000 | 10,000 |
| | Minuta nacional dhe Ballkan Perëndimor | | 500 | 1,000 | 1,500 | 2,000 | 3,000 | 4,000 |
| | SMS Vala, nacional dhe Ballkan Perëndimor | | 300 | 500 | 600 | 800 | 1,000 | 1,500 |
| | **Internet për Kosovë** | | **25 GB** | **40 GB** | **60 GB** | **100 GB** | **150 GB** | **200 GB** |
| | Internet për Roaming në kuadër të internetit për Kosovë | Ballkan Perëndimor | 4 GB | 5 GB | 7 GB | 8 GB | 11 GB | 15 GB |
| | | Regjion | 1 GB | 2 GB | 3 GB | 3 GB | 4 GB | 5 GB |
| | | Evropë | 1 GB | 1 GB | 1 GB | 2 GB | 3 GB | 5 GB |

| | Postpaid Individual & Klubet Familjare | Çmimi |
|---|---|---|
| Tarifat | Thirrjet në CUG - Klubet Familjare | € 0.00 |
| | Thirrjet në Vala mobile dhe Vala fiks jashtë pakos dhe klubit CUG/min/60/60 | € 0.17 |
| | Thirrjet nacionale mobile dhe fikse (operatorët tjerë në Kosovë) jashtë pakos/min/60/30 | € 0.17 |
| | SMS në Vala jashtë pakos | € 0.02 |
| | SMS Nacional (operatorët tjerë në Kosovë) jashtë pakos | € 0.03 |
| | Pay as You Go (internet jashtë pakos) - 1GB (inkrement 100Kb) | € 1.99 |

*Në çmime është i përfshirë Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), përveç kur konsumatori është i liruar në bazë të ligjeve në fuqi.*

| Vlenë për: | Pako | Përmbajta | Validiteti | Çmimi | | Vlenë për: | Pako | Përmbajta | Validiteti | Çmimi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kosovë | 1 GB | 1 GB | 1 muaj | € 1.99 | | Shqipëri | ALB 200 | 200 MB | 1 ditë | € 1.49 |
| Kosovë | 2 GB | 2 GB | 1 muaj | € 2.99 | | Shqipëri | ALB 500 | 500 MB | 4 ditë | € 2.49 |
| Kosovë | 3 GB | 3 GB | 1 muaj | € 3.99 | | Shqipëri | ALB 1000 | 1,000 MB | 7 ditë | € 4.49 |
| Kosovë | 5 GB | 5 GB | 1 muaj | € 4.99 | | Shqipëri | ALB 2000 | 2,000 MB | 15 ditë | € 7.49 |
| Kosovë | 10 GB | 10 GB | 1 muaj | € 6.99 | | Shqipëri | ALB 4000 | 4,000 MB | 30 ditë | € 12.49 |
| Kosovë | Pa Limit | Pa Limit GB | 1 muaj | € 19.99 | | Evropë | EU 300 | 300 MB | 1 ditë | € 2.00 |
| Regjion | REG 500 | 500 MB | 1 ditë | € 2.00 | | Evropë | EU 500 | 500 MB | 4 ditë | € 4.00 |
| Regjion | REG 1000 | 1,000 MB | 4 ditë | € 4.00 | | Evropë | EU 1000 | 1,000 MB | 7 ditë | € 7.00 |
| Regjion | REG 2000 | 2,000 MB | 10 ditë | € 7.00 | | Evropë | EU 2000 | 2,000 MB | 10 ditë | € 10.00 |
| Regjion | REG 3000 | 3,000 MB | 30 ditë | € 10.00 | | Evropë | EU 5000 | 5,000 MB | 30 ditë | € 14.99 |

*Në çmime është i përfshirë Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), përveç kur konsumatori është i liruar në bazë të ligjeve në fuqi.*

1.3. Kufiri i konsumit financiar për shfrytëzimin jashtë pakove (pay-as-you-go), për Konsumatorin, si parazgjedhje është 20 euro. Megjithatë, Konsumatori mundet në çdo kohë përmes kërkesës me shkrim të bëjë ndryshimin e kufirit të konsumit financiar. MB (megabajtët) e pa konsumuar brenda periudhës mujore të faturimit nuk transferohen në muajin pasues dhe as nuk kompensohen në asnjë formë.

## 2. Afati i aktivizimit të shërbimeve

2.1. Data e aktivizimit të shërbimit do të bëhet menjëherë ose do të përcaktohet në mes palëve kontraktuese.

## 3. Shpejtësia e shërbimeve të internetit

3.1. Tabela e mëposhtme tregon shpejtësinë e internetit për paketat e faturimit mujor vetëm me internet dhe/ose me shërbime të kombinuara:

| Qasja në internet mobil | Shpejtësia maksimale e parashikuar/përcaktuar/vlerësuar * | | |
|---|---|---|---|
| | 2G | 3G | 4G |
| Shkarkim | 200 Kbps | 23 Mbps | 154 Mbps |
| Ngarkim | 100 Kbps | 7 Mbps | 62 Mbps |

*"Shpejtësia maksimale e vlerësuar" është shpejtësia maksimale që përdoruesit mund të presin të arrijnë në vende të ndryshme në zonën e mbulimit në kushte reale. Kjo vlerë maksimale rezulton nga matjet në të gjithë territorin kombëtar dhe mund të ndryshojë në varësi të performancës së pajisjes dhe vendndodhjes tuaj gjatë përdorimit të shërbimit.

## 4. Kohëzgjatja, ripërtërija dhe përfundimi

4.1. Në rastet kur kontrata lidhet me konsumator individual (person fizik), ajo mund të lidhet për një afat fillestar të përcaktuar nga dymbëdhjetë (12) deri në njëzet e katër (24) muaj, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.

4.2. TK do ta informojë konsumatorin me faturim mujor tridhjetë (30) ditë përpara, me anë të një mediumi të qëndrueshëm, për përfundimin e afatit fillestar të kontratës. Nëse konsumatori nuk e ndërpret kontratën, kjo kontratë do të rinovohet në heshtje për një periudhë të pacaktuar. Në rast të kërkesës për ndërprerje nga konsumatori, ai është i obliguar të na njoftoj së paku dhjetë (10) ditë para datës së përfundimin e afatit fillestar të kontratës.

4.3. Konsumatori pranon që nëse e ndërprenë kontratën gjatë periudhës së detyrueshme 9-mujore nëse e ka nënshkruar kontratën për një periudhë fillestare prej 12 muajsh, ose gjatë periudhës së detyrueshme 12 mujore nëse ka nënshkruar kontratën për një periudhë fillestare prej 24 muaj, detyrohet të kompensojë TK me pagesën mujore për muajt e mbetur të periudhës së detyrueshme, sipas çmimit të plotë të pakos, duke përfshirë edhe zbritjen e përfituar apo shpërblimin shtesë.

## 5. Karakteristikat për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara

5.1. TK ka vënë në dispozicion të përdoruesve fundorë me aftësi të kufizuara versionin në "large print" ose versionin audio të kontratës. Detajet për këtë qëllim publikohen në faqen zyrtare të Telekomit të Kosovës: www.kosovotelecom.com

## 6. Informacione tjera relevante

6.1. Me paraqitjen e kërkesës, konsumatori pranon termat dhe kushtet e përgjithshme dhe ato specifike, si dhe informacionet e tjera parakontraktore të disponueshme në linkun: www.kosovotelecom.com